



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Data 06 / 08 / 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi 45211200-1 (punime ndërtimi për shtëpi strehimi).

VLERA E FONDIT LIMIT :

27 114 876 (njëzetë e shtatë milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 3....

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.

7. Taksa për zënien e hapësirave publike.

8. Taksa e tabelës.

9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2024 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ” Për sistemin e taksave vendore”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) **vlerën e përlllogariturtë kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
- c) 40 % të vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e

Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*

b) *Situacion përfundimtare të objektit,*

c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*

d) *Akt Kolaudimi*

e) *Faturat tatimore*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*

b) *Situacion përfundimtare të objektit,*

c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*

d) *Akti i Kolaudimit*

e) *Faturat tatimore,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

1. NP– 3A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale,veshje dhe fasada

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

1. NS - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre

2. NS - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
3. NS - 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP –3 A (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje dhe fasada konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.).

Duke parë dhe vetë objektin e prokurimit i cili është “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara” kjo kategori ndërtimi përkon dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me investimin që do të kryhet (e cila përshtatet me çdo zë të preventivit të punimeve). Bazuar mbi objektin e prokurimit, qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është ndërtimi nga e para e 12 shtëpive të banimit për komunitetet në nevojë në një kat të vetëm, duke i siguruar atyre kushte më të mira jetesë në shtëpitë e tyre. Bazuar dhe nga preventive i punimeve

ku përfshin punë të tilla si Suvatim i zakonshëm fasade, suva Brenda mur tulle Shtresë betoni C, Çati vendi H~8m mbuluar me tjegulla vendi, Mur me tulle, Mur me blloqe, Tavan i varur plastic etj, të cilat janë në përputhje me liçensën e mësipërme të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 2 A (Impjante hidrosanitare,kuzhina,lavanteri mirëmbajtje konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme .

Duke analizuar preventivin e punimeve, punime hidraulike janë parashikuar për të gjitha shtëpive që do të ndërtohen nga e para si punime tub plastike 50p, tub kanalizimi, F.V WC allafrenga komplet, F V bolier 80 liter , F.V lavaman porcelani importi me mishelator, F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm PN 25, të cilat cilësohen punime hidraulike dhe të lidhura me to. Kërkesa që operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë liçensën NS 2 A është një kërkesë në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e prokurimit dhe njëkohësisht garanton autoritetin kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës dhe në kohë.

NS - 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm) .

Duke analizuar preventivin e punimeve, kjo kategori license përkon pikërisht me punimet si më poshtë :

si psh Suva e zakonshme fasade, suva Brenda mur tulle, F.V Dritare d/alumini dyfish xham, FV dyer të brendshme tamburtat të rimesuar, dyer të blinduar importi si dhe bojë hidroplastike etj.

NS - 14 A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe

të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme .)

Duke analizuar preventivin e punimeve për rikonstruksionin e 39 shtëpive, kërkesa e mësipërme del një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës për zërat e preventivit për punime elektrike si, përcjellës elektrik PV-500 Φ 1.5 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 2.5 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 4 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 6 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 2x1.5 mm², çelës 2 polar 220V 10A Gevis (*ose ekuivalent*), priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A Gevis universal (*ose ekuivalent*), kuti derivacioni plastike, kuti support pllaket 4 modular Gevis (*ose ekuivalent*), portollamba normale, automat kryesor me 24 vende, siguresa 25a, diferencial 220 V 40A, llampa sinjali 220V.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- | | |
|--------------------------|---------|
| 1) Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| 2) Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| 3) Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| 4) Inxhinier Topograf | 1 (një) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë .

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar te stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier ndërtimi, Hidroteknik, Elektrik dhe Topograf parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

➤ **Inxhinier Ndërtimi** **1 (një)**

Nga zërat e preventivit dhe natyra e objektit të prokurimit dhe në zbatim të VKM 629 datë 13.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” janë përcaktur numri i punonjësve dhe stafi i kualifikuar me licencë

ose dëshmi të lëshuara nga autoritet e përcaktuara me ligj. Kërkesa për një inxh. Ndërtimi që të jenë në licencën e shoqërisë është vendosur në zbatim të Kodit të Punës, kohëzgjatja javore e punës 48 orë për një periudhë të gjatë pune (afati i realizimit të punimeve të kontratës është 4 muaj, në zbatim të VKM nr.42 datë 16.01.2008 Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrijnë Veprimtari Ndërtimi”, pika II :c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 4 mujore, për ndërtimin e objekteve .

Specialiteti i inxhinierëve të ndërtimit është vendosur në zbatim të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 Kreu IV “Drejtuesi Teknik i shoqërisë dhe pa pajtueshmëria me këtë detyrë ”.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik (inxhinier ndërtimi të cilët janë njëherazi dhe drejtues teknik) për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Duke analizuar preventivin e punimeve dhe parë objektin e prokurimit i cili është “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara” dhe zërat përkatës në preventiv ku shumica prej tyre janë punë ndërtimi, del i nevojshëm që operatori ekonomik fitues duhet të disponoj një inxhinier ndërtimi.

➤ **Inxhinier Hidroteknik 1 (një)**

Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit Hidroteknik, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier Hidroteknik, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, faktin që punimet do të kryhen në një shesh ndërtimi të vetëm, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme .

Duke analizuar preventivin e punimeve, punime hidraulike janë parashikuar për të gjitha shtëpive që do të rikonstruktohen nga e para si punime tub plastike 50p, tub kanalizimi, F.V WC allafrenga komplet, F V bolier 80 liter , F.V lavaman porcelani importi me mishelator, F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm PN 25, të cilat cilësohen punime hidraulike dhe të lidhura me to.

➤ **Inxhinier Elektrik** **1 (një)**

Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit elektrik, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier elektrik, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, faktin që punimet do të kryhen në një shesh ndërtimi të vetëm, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme .

Duke analizuar preventivin e punimeve për rikonstruksionin e 39 shtëpive, kërkesa e mësipërme del një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës për zërat e preventivit për punime elektrike si, përcjellës elektrik PV-500 Φ 1.5 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 2.5 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 4 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 6 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 2x1.5 mm², çelës 2 polar 220V 10A Gevis (*ose ekuivalent*), priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A Gevis universal (*ose ekuivalent*), kuti derivacioni plastike, kuti support pllaket 4 modular Gevis (*ose ekuivalent*), portollamba normale, automat kryesor me 24 vende, siguresa 25a, diferencial 220 V 40A, llampa sinjali 220V etj.

➤ **Inxhinier Topograf** **1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rievitimin e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/ ose certifikatë trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria

e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjes të pajisur me çertifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

Njësia e prokurimit e gjykon së kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës, për shkak se garantimi i ekspertit së mbrojtjes e shëndetit në punë nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kriteri i mësipërm lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë autoriteti kontraktor ka pranuar edhe disponimin me çertifikata trajnime apo çertifikata ekuivalente të tyre, duke i shërbyer autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës, si dhe duke lehtësuar operatorët ekonomik ofertues në përmbushjen e këtij kriteri.

Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “*Për mbrojtjen e mjedisit*”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës si staf teknik punonjësit si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	PUNONJËS
1	Punonjës/specialist duralumini	1 (një)
2	Mekanik	1 (një)
3	Hidroizolues	1 (një)
4	Hidraulik	2 (dy)
5	Elektracist	2 (dy)
6	Karpentiere	2 (dy)
7	Teknik ndërtimi	1 (një)
8	Punetor/Specialist ndertimi	1 (një)
9	Hekurkthyes	2 dy)
10	Pllakashtrues	2 (dy)
11	Manovrator	2 (dy)
12	Shofer	2 (dy)
13	Murator	2 (dy)
14	Teknik Topograf	1 (një)

	Totali 22 punonjës	
--	--------------------	--

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, **ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)**, kontrate pune e vlefshme, certifikatat përkatëse si edhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 3 mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR.

Në rastin kur mjetet e kërkuar më poshtë në pikën 2.3.10 janë me qera nuk është kusht që shoferët të jenë në listëpagesën e shoqërisë, ata do të lejohen të plotësohen nga ofertuesit **edhe nëpërmjet kontraktimit.**

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar / kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet / kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime / kualifikime).

Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4 dhe 2.3.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

Për Punonjës/specialist duralumini 1 (një) person, nevojitet prezenca e tyre në kantier për ndërtimin e shtesës së katit duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime dyer dritare dhe konkretisht, Dyer te blinduara importi, F.V.

dyer te brendshme tamburate te rimesuara, F.V. dritare d/alumin dyfish xham, Dyer duralumini dopio xham.

Njësia e prokurimit, referuar preventivit të punimeve gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e zërave të preventivit si më sipër cituar, dhe konkretisht 1 (një) punonjës/specialist duralumini është i mjaftueshëm për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për Mekanik 1 (një) person

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, kërkojnë një numër të konsiderueshëm për mjete dhe pajisjesh teknike. Përcaktimi i kriterit për disponimin e 1 (një) mekaniku për mirëmbajtjen e tyre me qëllim që puna mos të pezullohet asnjëher, është i domosdoshme për të mbikqyrur makineritë dhe mekanizmat që nevojiten për kryerjen e këtyre punimeve.

Për Hidroizolues 1 (një) person nevojitet prezenca e tij në kantier për rikonstrukcionin e shtëpisë duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime 2.197 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama për shtëpinë e Znj Suzana Behari, punime të cilat kryhen nga punonjësi i përmendur më sipër.

Nga orët e punës të përlogaritur nga njësia e prokurimit për punime hidroizolimi që do të kryhen, del i nevojshëm 1 (një) punonjës hidroizolues për zbatimin e kontratës me sukses.

Për Hidraulik 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për rikonstruksionin e 39 shtëpive të familjeve në nevojë duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses për punimet hidraulike..

Duke analizuar preventivin e punimeve, punime hidraulike janë parashikuar për të gjitha shtëpive që do të rikonstruktohen nga e para si punime tub plastike 50p, tub kanalizimi, F.V WC allafrenga komplet, F V bolier 80 liter , F.V lavaman porcelani importi me mishelator, F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm PN 25, të cilat cilësohen punime hidraulike dhe të lidhura me to.

Nga përlogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për hidraulik, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për Elektricitist 2 (dy) persona nevojitet prezenca e tyre në kantier për rikonstruksionin e 39 shtëpive të familjeve në nevojë duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses për punime elektrike .

Duke analizuar preventivin e punimeve për rikonstruksionin e 39 shtëpive, kërkesa e mësipërme del një kërkesë e domosdosshme për realizimin me sukses të kontratës për zërat e preventivit për punime elektrike si, përcjellës elektrik PV-500 Φ 1.5 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 2.5 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 4 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 6 mm², përcjellës elektrik PV-500 Φ 2x1.5 mm², çelës 2 polar 220V 10A Gevis (*ose ekuivalent*), priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A Gevis universal (*ose ekuivalent*), kuti derivacioni plastike, kuti support pllaket 4 modular Gevis (*ose ekuivalent*), portollamba normale, automat kryesor me 24 vende, siguresa 25a, diferencial 220 V 40A, llampa sinjali 220V etj.

Bazuar në preventiv, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për elektricitist dhe konkretisht 2 (dy) punonjës), duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për Karpentier 2 (dy) persona, NJP gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses, dhe konkretisht ata nevojiten për ngritjen e skelave (armature druri betofarma 500 m² sipas shtojcës së mjeteve dhe pajisjet teknike), për ngritjen e strukturave të betolit monolite (kollona) për çatitë etj.

Për specialist ndërtimi 1 (një) person dhe teknik ndërtimi 1 (një) person, nevojitet prezenca e tyre në kantier për rikonstruksionin e 39 shtëpive duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime, F V hekur Φ 6 - 10 mm, F v hekur $\Phi > 10$ mm, struktura monolite betoni (kollona), mur me tulle të lehtësuara dopio deri 8m me llaç të përzier M25 mur me tulle me 8 vrima, Shtrese betoni C, punime të cilat kryhen nga punonjësit e përmendur më sipër.

Lidhur me numrin e specialistëve të kërkuar për specialist ndërtimi 1 (një) dhe teknik ndërtimi 1 (një) person, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë

Për Hekurkthyes 2 (dy) persona nevojitet prezenca e tyre në kantier për rikonstruksionin e 39 shtëpive të familjeve në nevojë duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime 2.166 F.V. Hekur Ø 6-10, 2.167 F.V. Hekur Ø > 10, punime të cilat kryhen nga punonjësit e përmendur më sipër.

Lidhur me numrin e specialistëve të kërkuar për hekurkthyes 2 (dy) persona, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë për rikonstruksionin e 39 shtëpive.

Për Pllakashtrues 2 (dy) persona nevojitet prezenca e tyre në kantier për ndërtimin e shtesës së katit duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime nivelimi, 2.267/b Shtrese me pllaka grez importi 40x40 për pothuajse të gjitha shtëpitë që do të rikonstruktohen, punime të cilat kryhen nga punonjësi i përmendur më sipër.

Duke parë volumin e madh të punimeve të sipërcituar sipas preventivit të punimeve, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish pllakashtrues për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

Për Manovrator 2 (dy) dhe shofer 2 (dy) persona njësia e prokurimit gjykon se kjo kërkesë përshtatet me manovrimin e mjeteve të kërkuar në shtojcën për disponimin e mjeteve teknike si : Kamion vetë shkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton 2 (dy) copë, Kamion vetë shkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton 2 (dy) cope, kamioncinë 3 deri në 5 ton 2 copë, , kamion me vinç 1 copë, autobetoniere mjet 1 copë, autopompë betoni mjet 1 copë, vinç kulle jo më pak se 15 m (1 copë), Dumper, Eskavator me goma , Minieskavator me zinxhir, Mini fadrome bobcat etj.

Duke marrë në konsideratë faktin se për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, nevojitet një numër i konsiderueshëm mjeteve për rikonstruksionin e 39 shtëpive të familjeve në nevojë, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e punonjësve të sipërcituar nga ana e ofertuesve është një kërkesë në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e kontratës, dhe nuk shkon përtej asaj çfarë është e nevojshme.

Në lidhje Teknik Topograf 1 (një) person, nevojitet prezenca e tij në kantier për të kryer rilevimet e tokës dhe piketimit në lidhje me ndërtimin e disa shtëpive nga e para duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses nën udhëheqjen e inxhinierit topograf.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 28 (njëzetë e tetë) persona për një periudhën 3 (tre) muajore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj 6 (gjashtë) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i

punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar dmosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Njësia e prokurimit është bazuar në Manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre ne E-Albania.

Duke analizuar proceset e punës të nevojshme për zbatimin e kontratës NJP ka kërkuar inxhinierët përkatët, punonjësit e kualifikuar si të argumentuar në pikën, 2.3.5, 2.3.4 dhe 2..3.3 dhe nga mbledhja e numrit të tyre rezulton se për zbatimin e kontratës me sukses nevojitet 28 (njëzetë e tetë) punonjës.

Vërtetimi se operatorët ekonomik ofertues disponojnë punonjësit e mësipërm për 1 periudhë minimale 3 (tre) mujore në listëpagesa duke filluar nga publikimi i njoftimit të kontratës, është një kërkesë bindëse për autoritetin kontraktor në kuptim të ligjit të prokurimit publik, duke krijuar besueshmerinë dhe reputacionit për zbatimin me sukses të kontratës dhe në kohë. Kontrata e punës është lidhja që bëhet ndërmjet operatorit ekonomik dhe inxhinierëve të mësipërm që ata janë punonjës me kohë të plotë pranë firmës .

2.3.9 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit), ose ekuivalent.
- ISO 45001-2018 (Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) **e vlefshme, ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK

kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkoj certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme .

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo certifikatë është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësisia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambientit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) e vlefshme, ose ekuivalent**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime të zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

2.3.10 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine deri ne 3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me Vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Pomp penobetoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
7	Autobeniere mjet	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Cope 1
12	Armatura druri (betoforma) 500 m2	në pronësi ose me qira	500 m2
13	Vinç kullë me krah jo me pak se 5 meter	në pronësi ose me qira	Cope 1
14	Aparat topogjeodezik me GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Depozite uji 1000l	në pronësi ose me qira	Cope 1
16	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Dumper	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Mini fadrome bobcat	në pronësi ose me qira	Copë 1

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .*

- *Për Fabrikën e Prodhimit dyer dritare PVC dhe duralumin, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kontratë blerje të makinerisë, çertifikatat e konformitetit ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, si dhe ISO 14001:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalent.*

Në rastin kur fabrika është me qera ose me kontratë furnizimi, ekonomik duhet të disponoj të gjithë dokumentacionin e mësipërm si edhe dokumentacionin që vërteton lidhjet e shoqërisë prodhuese me distributorin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të

prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :

- Në lidhje me kamion vetëshkarkues 2 copë me kapacitet mbi 20 ton, Kamion vetëshkarkues 2 copë me kapacitet min 10 ton njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve dhe konkretisht tek zërat 2.166 F.V. Hekur Ø 6-10. Duke qënë se hekuri prodhohet standart 12m, disponueshmëria e 1 kamionit të sipërcituar në përmasa të mëdha është i domosdoshëm për transportimin e këtyre materialeve pranë kantierit të ndërtimit.

Një tjetër process pune që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për transportimin e të gjitha materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht :

për transportimin e materialeve si Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 8m me llaç perzier M25, Mur me tulle me 8 vrima, t=10cm, h~3m, llaç perzier M15, si dhe për transportimin e . Pllaka gres në sasinë 730 m², dhe pllaka majolike ne WC, etj. Duke marrë në konsideratë faktin se do të rikonstruktohen 39 shtëpi për një afat 6 (gjashtë) muaj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të përshtatshëm mjeteve për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- Kamioncine deri ne 3 ton 2 copë janë të nevojshëm për transportimin e materialeve hidraulike, elektrike si dhe për punimet dyer dritare.
Disponueshmëria e mjeteve të mësipërme nga ana e operatorëve ekonomik ofertues, garanton autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e materialeve objekt kontrate si dhe duke kryer të gjitha proceset e punës në përputhje me objektin e prokurimit dhe afatet kohore të parashikuar në grafikun e punimeve.
Njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e mësipërme është në përputhje me vëllimin e kontratës.

- Në lidhje me kamion me vinç 1 copë, njësia e prokurimit sqaron se këto mjete janë të nevojshme për shkarkimin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit.
Disponimi i mjetit të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kontraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun e punimeve.

- Në lidhje me autobetoniere mjet 1 copë, autopompë betoni mjet 1 copë, pompë suvatimi, vibrator betoni 2 copë, autobot uji 1 copë, pompë uji 1 copë, pomp penobetonit depozitë uji 1 copë si dhe pajisje niveluese për nivelim stresash 1 copë njësia e prokurimit gjykon se duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen dhe preventivin e punimeve të hartuar nga autoriteti kontraktor, vërejmë punime ndërtimi të nevojshëm për mjetet dhe pajisjet teknike të mësipërme si psh Suva e brendshme, Shtresë betoni c në sasinë 56 m³, për pothuajse të gjitha shtëpive ku do të kryhet investimi, etj.
Lidhur me zërat e preventit më sipër, autoriteti kontraktor sqaron se hedhja e llaçit në vepër dhe konkretisht në 39 shtëpive ku do të kryhet investimi për familjet në nevojë, kryhen nga mjete të posaçme dhe konkretisht nga autobetoniere mjet dhe autopompë betoni mjet. Mjetet dhe pajisje e tjera teknike janë kërkuar në përputhje me vëllimin e punimeve që do të kryhen. Vibrator betoni, pompë suvatimi si dhe pajisje niveluese për nivelim stresash janë të nevojshëm për suvatimin e katit jashtë dhe brenda si dhe nivelimin e betonit. Në lidhje me autobotin e ujit, pompë uji si dhe depozitë uji shërben për përgatitjen e llaçit dhe për lagjen në lartësi të objektit.

- Në lidhje me vinç kulle me krahë jo më pak se 5 m, njësia e prokurimit sqaron se disponueshmërin e këtij mjeti lidhet drejtëpërdrejtë me ngritjen e tjegullave në vepër dhe konkretisht në çatitë e shtëpive, duke krijuar një proces punë më të lehtë për punonjësit që do të kryejnë punë në lartësi për montimin e tyre. Duke analizuar dhe preventin e punimeve dhe konkretisht zërin 2.218 Cati vendi H~ 8 m mbuluar me tjegulla vendi në sasinë të mëdha, si dhe duke u bazuar në afatin kohor të përcaktuar në grafikun e punimeve i cili përcakton se ky punim duhet të kryhet dhe të përfundojë në

muajin e dytë, disponimi i këtij mjetei garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke mos sjellë vonesa.

- Në lidhje me apartin topogjeodezik me GPS, njësia e prokurimit sqaron se kjo pajisje është e nevojshme për piketimin e objektit nga topografi.
- Në lidhje me Armatura druri (betoforma) 500 m², njësia e prokurimit gjykon se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Duke marrë parasysh faktin se do të rikonstruktohen 39 shtëpi banimi, disponimi i armaturës së mësipërme është i nevojshëm për kryerjen e këtij investimi. Njësia e prokurimit ka parashikuar një minimum të mundshëm m² për armaturën.
- Në lidhje me Dumper Copë 1, dhe Mini fadrome bobcat Copë 1, njësia e prokurimit vlerëson se për sa kohë disa shtëpi do të ndërtohen nga e para, nevojiten mjetet e mësipërme për gërmime dhe sistemime të tokës, nivelimet e tyre dhe shtresave si dhe heqjen e mbeturina pas procesit të punës. Proceset e tjera të punës do të kryhen edhe në shtëpitë e tjera për rilevimet e tokës, shtresave etj. Duke marrë në konsideratë numrin e madh të shtëpive të cilët janë 39, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal mjetesh për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.11 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë :

- *Fabrikë për Prodhimin e dyer dritare PVC në pronësi me qira/ose kontratë furnizimi.*

Për Fabrikën e Prodhimit dyer dritare PVC dhe duralumin operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kontratë blerje te makinerisë, çertifikatat e konformitetit ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent.

Në rastin kur fabrika është me qera ose me kontratë furnizimi, ekonomik duhet të disponoj të gjithë dokumentacionin e mësipërm si edhe dokumentacionin që vërteton lidhjet e shoqërisë prodhuese me distributorin.

- Në lidhje me Fabrikë prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të Fabrikë prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit duke përfshirë që këto materiale të jenë të çertifikuar sipas standarit ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik, duke rritur efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik .

Në preventin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime dyer dritare për pothuajse të gjitha shtëpitë që do të rikonstruktohen si psh, 2.395 Dyer d/alumini tek xham, 3.375 Dritare d/alumini tek xham, 2.388/1 FV dyer te brendshme tamburtat te rimesuar etj.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime

dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në çdo rast nëse janë përmendur markë prodhimi ose proces i veçantë pranohen edhe ekuivalent.

NJËSIA E PROKURIMIT